



14 shtator 2012, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Mos respektimi i kriterëve të ndërtimit të ndëshkohet nga institucionet

Gjatë muajit shtator ka vazhduar monitorimi i punës së ekzekutivit të komunës së Prizrenit. Gjatë kësaj periudhe në fokus të monitorimit kanë qenë sektori i urbanizmit dhe ai i inspektorateve, respektivisht ndërtimet në Qendrën Historike të Prizrenit. EC Ma Ndryshe shpreh shqetësim me gjendjen e krijuar në fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor në Qendrën Historike të Prizrenit, ku ndërtimet vazhdojnë me shpërfillje të lejeve të ndërtimit të dhëna nga DUPH-ja.

EC Ma Ndryshe kërkon nga Kryetari Ramadan Muja që të iniciohen procedurat për rrënimin e të gjitha ndërtimeve pa leje dhe atyre që janë bërë jashtë kriterëve të ndërtimit, në Qendrën Historike të Prizrenit dhe kështu të ndalohet trendi i degradimit urban të pjesës historike të qytetit. Këtë trend e konfirmojnë rastet konkrete, që janë hulumtuar nga monitoruesit e EC Ma Ndryshe.

Kompleksi afaristo-banesor “Euro-Center” është ndërtuar në Zonën e Mbrojtur të Qendrës Historike të Prizrenit. Fillimisht Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore ka dhënë Pëlqim me datë 05.02.2009 me numër protokollit 24. Pas lëshimit të pëlqimit, drejtorja e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinorë lëshon lejen ndërtimore me nr.04/4-351-70 të datës 29.06.2009 me katëshmëri 2B+P+2. Në aktvendimin e datës 29.12.2010 në pjesën e arsyetimit të këtij aktvendimi thuhet “investuesi i punimeve i ka kryer pagesën për ndërtimin e katit të tretë pranë drejtorisë së urbanizmit ndërsa për ndërtimin e katit të katërt ku janë kryer të gjitha punimet e vrazhda nuk posedon leje ndërtimi” - çka len të nënkuptohet se inspektorati (ekzekutivi komunal) tregohet “human” ndaj këtij investitori duke i mundësuar ndërtim më etazhitet më të lartë.

Pos ndërtimit tanimë të përfunduar të këtij objekti, ky investitor, nuk është ndalur më kaq duke filluar edhe aneksin tjetër po ashtu pranë këtij objekti pa kurrfarë kriteri. Mirëpo ky nuk është rasti i vetëm që investitorët nuk respektojnë lejen ndërtimore. Një objekt i tillë është në ndërtim e sipër dhe përgjegjësit duhet të ndërmarrin veprime parandaluese në afat sa më të shkurtër kohor, ngase në të kundërtën do të jetë vonë, si në rastin e “Euro-Center”.

Konkretisht për tejkalimet në ndërtimin e vrazhdë pranë shtëpisë së Shuaip Spahisë më 5 shtator të këtij viti IMMK-ja ka alarmuar Drejtorinë e Inspektorateve të komunës së Prizrenit. Sipas aktvendimit të Drejtorisë së Inspektorateve të datës 7 shtator 2012, investitori nuk i është përmbajtur lejes urbanistike “dhe ka bërë tejkalim në gabarit dhe etazhitet të objektit”. Me këtë aktvendim DI-ja ka urdhëruar investuesin e punimeve që në afatin prej 7 ditësh të bëjë rrënimin e pjesës shtesë në gabarit dhe etazhitet.

Për këtë rast ka reaguar edhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Prizren, fillimisht më 24 prill dhe më pas më 10 shtator ku nga komuna e Inspektoratet, MKRS-ja e IMMK-ja është kërkuar “inspektimi i punimeve dhe verifikimin e projektit të lejuar, pasi që objekti ka shkuar shumë lartë dhe e ka

ngulfatur pamjen e xhamisë Sejdiu Beu.” Ndërsa më 12 shtator 2012 DI-ja ka parashtruar një kërkesë pranë Gjykatës për Kundërvajtje për fillimin e procedurës kundërvajtëse. me arsyetimin se investuesi nuk e ka respektuar lejen e ndërtimit të lëshuar nga DUPH-ja. (shkresat janë të bashkëngjitura bashkë me komunikatën)

Muaj më parë monitoruesit e EC Ma Ndryshe patën konstatuar shkelje flagrante në këtë zonë në punimet e bëra në: Hotel Therandë, ish shtëpia e Mallrave në Shatërvan, ndërtimi i vrazhdë pranë objektit të IMMK-së, ndërtimi i disa hoteleve, etj.

EC Ma Ndryshe përsërit thirrjen që qeveria lokale e Prizrenit, urgjentisht të ndërmarrë veprime të nevojshme në drejtim të normalizimit të gjendjes në Qendrën Historike të Prizrenit dhe të zbatoj në përpikëri Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit (2008).

Ekzekutivi komunal duhet të ndërmarrë veprime konkrete parandaluese, ndërsa në rast të vazhdimit të punimeve, edhe veprime ndëshkuese ndaj personave që nuk i respektojnë kriteret e ndërtimit. Madje, siç përshkruhet edhe në njërin prej procesverbaleve të DI-së, meqë investuesit nuk e kryejnë rrënimin vullnetar, atëherë ky organ duhet të bëj rrënimin e dhunshëm të etazheve shtesë me kosto që do t'i përshkruhej investuesve të papërgjegjshëm.

Në të njëjtën kohë EC Ma Ndryshe kërkon veprim më të fuqishëm ndër-institucional dhe i bën thirrje gjyqësorit që t'i merr parasysh shkresat e ekspertëve të komunës së Prizrenit dhe të inicioj procedurat gjyqësore ndaj atyre që shkelin dispozitat e Rregullores për Ndërtimin e Objekteve.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti “Transparenca online e komunës së Prizrenit” prej muajit shtator 2012 përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.